

VENDIM
Nr.398, datë 22.4.2009

PER DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.115, DATË 2.2.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË
TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2009, NË DISA MINISTRI DHE INSTITUCIONE
QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 1 e 3 të vendimin nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, për ministritë dhe institucionet qendrore është 2568 punonjës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë detajimin e numrit të punonjësve, sipas lidhjes nr.1 të pikës 1, me profesione dhe afate kohore, brenda kriterëve të vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe të veprimtarive sezonale/përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Grupi	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve
02	Kuvendi i Shqipërisë	11
03	Këshilli i Ministrave	1
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	44
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	213
06	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	811
10	Ministria e Financave	49
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	113
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	22
13	Ministria e Shëndetësisë	8
14	Ministria e Drejtësisë	30
15	Ministria e Punëve të Jashtme	16
16	Ministria e Brendshme	562
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	40
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	30
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	83
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	140
28	Prokuroria e Përgjithshme	5

30	Gjykata Kushtetuese	2
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	3
50	INSTAT	378
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	2
77	Autoriteti i Konkurrencës	2
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	1
87	Institucione të tjera qeveritare	2
	Total numri i punonjësve	2568